



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranuar - Prilapjen Më Datën 14.04.2025			
Nr. Dokument Orig. Breg	Nr. Dokument Kopje	Natypa Llogarit	Vlera Vrednost
02-035/02-325			



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale NR.03/L-040(Gazeta Zyrtare NR 28/2008), lidhur me nenin 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 23.12.2016, dhe neni 10 i Rregullores Nr.01-110/05-161 të datës 01.03.2023 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënjes në Shfrytëzim më pak se Një vitë të Pronës së Paluajtshme të komunës, Kryetari i Komunës së Vitisë, me datë 14.04.2025 nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR DHËNJEN NË SHFRYTËZIM MË PAK SE 1 (NJË) VITË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

I. Me këtë Vendim, kryetari i Komunës së Vitisë, formon komision për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave që parashtrihen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme për hapsirat publike të komunës në shfrytëzim më pak se 1(një) vitë.

Komisioni përbëhet prej 3 Anëtarë dhe ka këtë përbërje:

1. Driton Halabaku - Kryetar i komisionit,
2. Mustafë Islami - Anëtar i komisionit,
3. Destan Avdyli – Anëtar i komisionit,

II. Ky komision nga pika I i këtij Vendimi, është me mandatë dy(2) vite.

III. Komisioni nga pika I i këtij Vendimi, ka për detyrë dhe përgjegjësi që të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të cilat parashtrihen nga personat fizik dhe juridik, për marrjen e pronës së paluajtshme për hapsirat publike të komunës, në shfrytëzim më pak se një vitë, konformë rregullores NR.01-110/05-161 e datës 01.03.2023 për përcaktimin e procedurave të dhënjes në shfrytëzim më pak se Një vitë të pronës së paluajtshme të komunës dhe ti rekomandoj kryetarit të komunës për nënshkrimin e kontratës ose marrjen e vendimit.

IV. Për implementimin e këtij vendimi do përkujdeset kryetari i komisionit ndërsa për zbatim Kryetari i Komunes së Vitisë.

V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Anëtarëve të Komisionit,
2. Zyrës së Kryetarit,
3. Zyres Ligjore,
4. Arkivit,

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË

Sokol Halit

